



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## **FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË FORUMIN RAJONAL PËR REFORMËN NË SISTEMIN E DREJTËSISË NË SHQIPËRI**

*Shkodër, 16 qershor 2015*

Takimi i sotëm është jo vetëm një hap i rëndësishëm në reformën në drejtësi. Ai është, gjithashtu, një arritje e rëndësishme në funksion të demokracisë pjesëmarrëse dhe të përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara në një proces konsultimi **gjithëpërfshirës, transparent dhe të udhëhequr prej shqiptarëve**. Ky është një proces të cilin Prezenca e OSBE-së është e përkushtuar për ta mbështetur edhe më tej.

Pse është kaq e rëndësishme që reforma ligjore të jetë **gjithëpërfshirëse dhe transparente**? Shqipëria është zotuar të respektojë angazhimet e OSBE-së, ndër të cilat janë transparenca dhe angazhimi qytetar – që i garantojnë çdo qytetari të drejtën për t’iu drejtuar qeverisë dhe Kuvendit, si edhe për t’u dëgjuar për çështjet me interes publik.

Megjithatë, ky detyrim publik nuk është e vetmja arsye për të garantuar demokraci pjesëmarrëse. Konsultimet me personat më të prekur nga një ligj i caktuar janë rruga më e drejtpërdrejtë për të hartuar politika dhe ligje të shëndosha e të qëndrueshme. Përfshirja e publikut ndihmon në orientimin e politikave drejt interesit publik. Megjithëse, në fillim ,mund të duken si vonesa të panevojshme gjatë procesit legjislativ, praktika ndërkombëtare ka treguar se konsultimet me palët e interesuara janë dob dhe jo barrë; janë përfitim dhe jo kosto. Konsultimi me palët e interesuara nuk harxhon kohë, përkundrazi, e kursen kohën.

Ai kursen kohë, sepse përfshin palët e rëndësishme, angazhimi i të cilave është i nevojshëm për suksesin e reformës. Kjo nismë madhore politikash duhet të përfshijë jo vetëm ekspertët, siç janë anëtarët e Grupit të Punës, por të gjithë ata që mund të japin kontribut për përgatitjen dhe vënien në zbatim të politikave. Përpara se të merren vendime legjislative, bashkëbisedimi kombëtar duhet të mundësojë hapësirë për këdo që mund të preket prej këtyre vendimeve, me një fjalë, për çdo qytetar që dëshiron të kontribuojë për të ardhmen e drejtësisë në Shqipëri.

Dobinë e konsultimeve e ndiejnë të dyja palët: palët e interesuara kanë rastin të paraqesin interesat e tyre, ndërsa qeveria dhe legjislativi marrin këshilla nga personat e duhur në lidhje me ndikimin politikave të reformave. Konsultimet garantojnë projektligje më të mira që nga fillimi, duke pasur **më pak nevojë për ndryshime të mëvonshme**. Për më tepër, publiku që merr pjesë në zhvillimin e politikave do të ndihmojë në zbatimin e ligjeve që i njeh dhe i mbështet. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse kursen kostot e zbatimit të ligjit dhe pakëson fërkimet mes qytetarëve dhe nëpunësve publikë të tyre.

Nëse ka dyshime për vlerën e konsultimeve, mund të bëjmë pyetjen: “Nëse nuk e gjejmë kohën për ta bërë saktë herën e parë, kur do ta gjejmë kohën për ta bërë edhe një herë nga e para?”

Konsultimi nuk është punë vetëm e qeverisë apo e parlamentit. Nuk do të thotë vetëm që strukturat shtetërore të paraqesin propozime dhe shoqëria civile të bëjë komente mbi to. Konsultimi është atribut civil i të gjitha subjekteve me vokacion publik, përfshi shoqatat profesionale dhe OJF-të, median dhe universitetet. Është detyra e autoritetet publike t’i hapin derën pjesëmarrjes së shoqërisë civile, por është po aq edhe detyra juaj, detyra jonë, të trokasim në derë. Kjo vlen sidomos për reformën e shtetit të së drejtës. Sistemi i drejtësisë nuk u shërben avokatëve dhe gjykatësve, ai u shërben qytetarëve.

Theksoj se **pronarët e kësaj reforme janë shqiptarët**: institucionet demokratike të vendit dhe qytetarët. Përpjekjet për të zhvilluar sistemin e drejtësisë të së ardhmes duhet të kenë autorësi vërtet kombëtare, duhet të kenë autorësinë e secilit prej jush.

Ja përse jam kaq i gëzuar që gjendem sot me ju, ndërsa përfshihemi në një dialog kombëtar për reformën në drejtësi, duke u përqendruar tek arsimi ligjor. Sepse arsimi ligjor nuk është vetëm për avokatët. Ju, si edukues profesionistë, jeni në krye të edukimit të një vendi të tërë me kulturën e shtetit të së drejtës.

Ne, në OSBE, themi “shteti i së drejtës fillon nga ti”, që thekson rëndësinë themelore që ka krijimi i kulturës së shtetit të së drejtës. Sot, unë do të shtoja: “Reforma ligjore fillon - dhe mbaron - me ju”.